



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

PS.nr.33/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti Special, Kryetari i Trupit Gjykses: Gjyqtari Vesel Ismaili, me Bashkëpunëtorin Profesional Albert Haliti, në çështjen penale ndaj të akuzuarve: S.J dhe I.S, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të R. së Kosovës me shenjën PPS.nr.46/2023 të datës 24.07.2023 për veprat penale në bashkëkryerje ‘‘Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi’’ nga neni 404 par.1 dhe 3 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuari I.S edhe për veprën penale: ‘‘Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve’’, nga neni 366.1 i KPRK-së, , pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë fillestar e verbal, të mbajtur me datë 02.08.2023 në prezencën e Prokurores së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Fikrije Fejzullahu , të akuzuarit S.J me mbrojtësit e tij av. Millosh Delleviq dhe Dejan Vasiq nga Mitrovica të angazhuar me autorizim, akuzuarit I.S me mbrojtësin e tij Av. Lubomir Pantoviq nga Mitrovica i angazhuar me autorizim, me datë **03.08.2023** mori, përpiloi me shkrim dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

S.J, me pseudonimin N., i biri S... dhe dhe nëna V..., mbiemri i vajzërisë Gj..., i lindur më ... në B... Komuna e Sh..., tani me vendqëndrim në K..., Rruga ..., me nr. personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, me profesion punëtor në turizëm sezonal, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i R. së Serbisë, më parë i gjykuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për veprë tjetër penale, i gjendur nën masën e paraburgimit nga data 31.05.2023.

I.S, i biri M... dhe R..., e gjinisë L..., i lindur më në B..., tani me vendqëndrim në fsh. D.. rruga P... nr.20 Komuna e P..., R. e Sërbisë, me nr. personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i shkurorëzuar, me profesion hidroinstalues, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa gjykuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë për veprë tjetër penale, serb, shtetas i Serbisë, i gjendur në paraburgim nga data 31.05.2023.

JANË FAJTOR

Sepse:

I. Të akuzuarit **S.J dhe I.S**, me datën 30.05.2023, rreth orës 23:25, në pikë-kalimin kufitar në Jarinjë, Komuna e Leposaviqit, fillimisht e kanë kaluar kufirin dhe në bashkëkryerje kanë ndërmarrë të gjitha veprimet përgatitore të nevojshme, duke u pajisur me thika, çekanë, flamuj të Serbisë, shufër metalike, sprej, maskë dhe sende të tjera të destinuara për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, dëmtimin e objekteve publike dhe private si dhe shkaktimin e dëmtimeve trupore personave zyrtar, duke qenë në kontakt me pjesëmarrës tjerë të turmës në Leposaviq, janë pajtuar që ti bashkëngjiten turmës së dhunshme të protestuesve serb të datës 29.05.2023, me ç'rast protestuesit kishin ushtruar dhunë të pakontrolluar, me mjete të forta, mjete shpërthyes të improvizuara si dhe me armë zjarri, nga të cilat ishin lënduar të paktën 30 (tridhjetë) pjesëtarë të forcave paqeruajtëse të KFOR-it, 3 (tre) nga ta nga predhat e armëve të zjarrit, si dhe ishin shkaktuar dëme materiale të konsiderueshme në automjetet e KFOR-it, Policisë së Kosovë, si dhe në veturat e gazetarëve të cilët kanë mbuluar ngjarjet e kësaj dite, të cilat përfshijnë djegien e plotë të disa automjeteve ose dëmtimin fizik në masë të madhe, duke shkaktuar rrezik në shkallë të gjerë për jetën dhe trupin e shumë njerëzve dhe pasurisë, mirëpo, të njëjtit janë ndaluar nga ana e pjesëtarëve të policisë së Republikës së Kosovës dhe kështu është pamundësuar pjesëmarrja e tyre në turmën e lartpërmendur.

- me këto veprime në *bashkëkryerje* e kanë kryer veprën penale: *‘Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi’* nga neni 404 par.1 dhe 3 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

I akuzuari I.S në kohë dhe vend të përshkruar si në pikën **I** të këtij dispozitivi me rastin e ndalimit nga policia kufitare dhe gjatë kontrollimit të veturës së markës “Honda” me targa sllovene: MB-90-LHN, të cilën e drejtonte i akuzuari, në bagazhin e saj janë gjetur dhe sekuestruar katër sprej dhe një piper sprej për të cilat nuk kishte autorizim që ti mbajë.

- me këto veprime ka kryer veprën penale: *‘Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve’* nga neni 366 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata, në mbështetje të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 59, 67, 69, 76 dhe neneve 404 par.1 dhe 3 dhe 366 par.1 të KPRK-ës, e lidhur me nenin 364 të KPRK-së i:

GJYKON

Të akuzuarin S.J:

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **gjashtë (6) muaj**, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit pas shpalljes së aktgjyqimit i **zëvendësohet** me **dënimin me gjobë**, në shumën prej **shtatë mijë (7.000.00) Euro**.

Në dënimin e shqiptuar me gjobë, të akuzuarit i llogaritet koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 31.05.2023 deri 03.08.2023, gjithsej 65 ditë, ashtu që për një (1) ditë të kaluar nën masën e paraburgimit barazohet me njëzet (20) Euro, e që si gjobë që tani i gjykuari duhet të paguaj i mbetet shuma prej **pesë mijë e shtatëqind (5.700.00) Euro**.

Obligohet i gjykuari që konform nenit 43 par.2 të KPRK-së, dënimin e lartcekur ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i gjykuari në fjalë nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së do t'ja zëvendësojë me dënim me burg duke ja llogaritur për një ditë burg me njëzet (20) Euro.

Detyrohet i gjykuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën aq sa do të bëhen sipas fletëshpenzimoreve të kësaj gjykate, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **dyqind euro (200) euro**, ndërsa për fondin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **pesëdhjetë Euro (50) euro**.

Të gjitha shpenzimet e lartcekura, i njëjtat obligohet ti paguajë, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

Të akuzuarin I.S:

- Për veprën penale; *Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi*” në *bashkëkryerje* nga neni 404 par.1 dhe 3 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) **i shqipton:**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **gjashtë (6) muaj**, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit pas shpalljes së aktgjykimit i **zëvendësohet** me **dënimin me gjobë**, në shumën prej **shtatë mijë (7.000.00) Euro**.

- Për veprën penale: *‘Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve’* nga neni 366 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) i shqipton:

Dënim me gjobë në shumën prej **dymijë (2.000.00) Euro**.

Gjykata, në mbështetje të nenit 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të akuzuarit I.S, i shqipton:

DËNIMIN UNIK me gjobë në shumën prej **nëntë mijë (9.000.00) Euro**.

Në dënimin e shqiptuar me gjobë, të akuzuarit i llogaritet koha e kaluar nënë masën e paraburgimit nga data 31.05.2023 deri 03.08.2023, gjithsej 65 ditë, ashtu që një(1) ditë të kaluar nën masën e paraburgimit i llogaritet me njëzet (20) Euro, andaj i akuzuari duhet ti paguaj shumën prej **shtatë mijë e shtatëqind (7.700.00) Euro**.

Obligohet i gjykuari që konform nenit 43 par.2 të KPRK-së, gjobën e lartcekur ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i gjykuari në fjalë nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së do t’ja zëvendësojë me dënim me burg duke ja llogaritur për një ditë burg me njëzet (20) Euro.

Detyrohet i gjykuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën aq sa do të bëhen sipas fletëshpenzimes së kësaj gjykate, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumë prej

dyqind euro (200) euro, ndërsa për fondin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **pesëdhjetë Euro (50) euro**.

Konform nenit 67 të KPRK-së të akuzuarve **S.J** dhe **I.S** ju shqiptohet:

DËNIM PLOTËSUES

Urdhërohen dëbimi i të akuzuarve nga Territori i Republikës së Kosovës dhe secilit veç e veç ju ndalohet hyrja në territorin e R. së Kosovës në kohëzgjatje prej **tre (3) vite** nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Urdhërohet konfiskimi i përhershëm i sendeve të sekuestruara përkohësisht siç janë: katër s prej, një piper sprej, një shufër metalike, një çekan, pesë thika dhe një palë dara.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, Urdhërohet Policia e Kosovës që në bashkëpunim me Prokurorinë, sendet e konfiskuara t'i shkatërrojë sipas procedurave ligjore në fuqi.

Me aktvendim të veçantë, gjykata ju ka ndërprerë masën e paraburgimit dhe ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të akuzuarave.

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

1.Aktakuza

Me datë 20 Korrik 2023, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, në këtë çështje penale ka ngritur Aktakuzën PPS.nr.33/2023, kundër të pandehurve S.J dhe I.S, të akuzuar që në *bashkëkryerje* e kanë kryer veprën penale: ‘*Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi*’ nga neni 404 par.1 dhe 3 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe i pandehuri I.S i akuzuar edhe për veprën penale: ‘*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*’, nga neni 366.1 i KPRK-së

2. Kompetenca e Gjykatës

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrimin e aktakuzës ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore.

Sa i përket kompetencës territoriale gjykata vlerëson se ka kompetencë lidhur me këtë çështje penale-juridike dhe atë në kuptim të nenit 13 par.1 nën par 1.1 të Ligjit për Gjykatat ku përcaktohet se: ‘ *Në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, vepron Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës*’.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, në kuptim të nenit 5, 9 dhe 10 të Ligjit për Prokurorinë Speciale, ku përcaktohet kompetenca e PSKRK, si dhe duke u bazuar në nenin 21 të KPPRK-së ku përcaktohet se: ‘ *Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë zhvillon dhe çështjen e gjykon në të gjitha procedurat penale për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për Gjykatat*’, gjykata konstaton se ka kompetencë lëndore lidhur me këtë çështje penale-juridike.

3.Shqyrtimi fillestar

Gjykata pasi që fillimisht ka vlerësuar kompetencën, si dhe ka vlerësuar të metat formale dhe juridike të aktakuzës, duke vepruar sipas kësaj çështjeje penale, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 02.08.2023. ku kanë prezantuar: nga PSRK - Prokurori Fikrije Zejnullahu, të pandehurit S.J me mbrojtësit e tij sipas autorizimit Millosh Delleviq dhe Dejan Vasiq, dhe i akuzuari I.S me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av.Lubomir Pantoviq.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, Gjykata i ka dhënë mundësinë të pandehurve të deklarohet për fajësinë dhe të njëjtit e kanë pranuar fajësinë për veprat të cilat u vihen në barrë duke shtuar se janë penduar për veprat të cilat i kanë kryer dhe gjykatën e premtojnë se nuk do të përsërisin më vepër penale. Mbrojtësit e të pandehurve kanë deklaruar se janë plotësuar të gjitha kushtet nga neni 242 të KPPRK që gjykata ta pranoj pranim fajësinë të dhëne nga të pandehurit e tyre, dhe kanë propozuar që të merret aktvendim me të cilin do ta pranohet pranimi i fajësisë nga të mbrojturit e tyre.

Gjykata ka marrë mendimin e Prokurorit të Shtetit i cili deklaruar se: Duke pasur parasysh faktin se të akuzuarit që nga fillimi i procedurës penale kanë pasur mbrojtësit e tyre dhe mundësinë e konsultimit të mjaftueshëm me ta prokuroria konsideron se pranimi i fajësisë është në përputhje me dispozitat e KPP në njërën anë, e në anën tjetër edhe në përputhje me provat materiale me të cilat është arsyetuar dhe mbështetur aktakuza.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit dhe marrjes së mendimit nga ana e Prokurorit të Shtetit, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë në bazë të nenit 241 lidhur me nenin 230 të

KPPRK-së, duke gjetur se pranimi i fajësisë është i plotë në harmoni me provat që gjenden në shkresat e lëndës, po ashtu pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa imponim, duke qenë i njoftuar me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Po ashtu, gjykata ka vlerësuar se aktakuza nuk përmban shkelje ligjore apo gabime faktike dhe me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

4. Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprës penale

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që ti shpallë fajtor të pandehurit: S.J dhe I.S, që në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale: ‘*Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi*’ nga neni 404 par.1 dhe 3 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe të pandehuri I.S edhe për veprën penale: ‘*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*’, nga neni 366.1 i KPRK-së, dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se të njëjtit janë penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurve dhe se në veprimet e të tyre manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të këtyre veprave penale.

Me nenin 404 par 1 të KPRK-së përcaktohet se: ‘*Kushdo që merr pjesë në turmën e mbledhur prej më tepër se tetë personave, e cila me veprime të përbashkëta e privon personin tjetër nga jeta, i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjetër, shkakton rrezik të përgjithshëm, shkakton dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë ose kryen vepra tjera të rënda të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim apo tenton të kryejë vepra të tilla, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet*’, e që në rastin konkret, të pandehurit me veprimet e tyre, duke kaluar kufirin dhe në bashkëkryerje kanë ndërmarrë të gjitha veprimet përgatitore të nevojshme, duke u pajisur me thika, çekanë, flamuj të Serbisë, shufër metalike, sprej, maskë dhe sende të tjera të destinuara për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, dëmtimin e objekteve publike dhe private si dhe shkaktimin e dëmtimeve trupore personave zyrtar, duke qenë në kontakt me pjesëmarrës tjerë të turmës në Leposaviq, janë pajtuar që ti bashkëngjiten turmës së dhunshme të protestuesve serb të datës 29.05.2023, në të cilën turmë protestuesit kishin ushtruar dhunë të pakontrolluar, me mjete të forta, mjete shpërthyesë të improvizuara si dhe me armë zjarri, nga të cilat ishin lënduar të paktën 30 (tridhjetë) pjesëtarë të forcave paqeruajtëse të KFOR-it, 3 (tre) nga ta nga predhat e armëve të zjarrit, si dhe ishin shkakuar dëme materiale të konsiderueshme në automjetet e KFOR-it, Policisë së Kosovë, si dhe në veturat e gazetarëve të cilët kanë mbuluar ngjarjet e kësaj dite, të cilat përfshijnë djegien e plotë të disa automjeteve ose dëmtimin fizik në masë të madhe, duke shkakuar rrezik në shkallë të gjerë për jetën dhe trupin e shumë njerëzve dhe pasurisë, mirëpo, të njëjtit janë ndalur nga ana e pjesëtarëve të policisë së Republikës së Kosovës dhe kështu është pamundësuar pjesëmarrja e

tyre në turmën e lartpërmendur, dhe me këto veprime i kanë plotësuar të gjitha elementet e veprës penale si më lartë.

Po ashtu, me nenin 366 par 1 të KPRK-së përcaktohet se: *‘Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet’*, e që në rastin konkret, i pandehuri I.S, me rastin e ndalimit nga policia kufitare dhe gjatë kontrollimit të veturës së markës “Honda” me targa sllovene: MB-90-LHN, të cilën e drejtonte i akuzuari, në bagazhin e saj janë gjetur dhe sekuestruar katër sprej dhe një piper sprej për të cilat nuk kishte autorizim që ti mbajë, me çka janë plotësuar të gjitha elementet e veprës penale si më lartë.

5. Vendimi mbi sanksionin penal

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat kanë ndikuar në caktimin, llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethanë lehtësuese ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë si dhe pendimin e shprehur, ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore që kanë mundur të shkaktojnë veprimet e të pandehurve dhe se veprimet e tyre kanë qenë të planifikuara.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe karakteristikat personale të pandehurit, dhe se edhe me dënimin e shqiptuar, mjaftueshëm do të ndikoj në risocializimin dhe në riedukimin e të pandehurit. Po ashtu ky dënim do të ndikoj edhe në aspektin e preventivës gjenerale që t’i ndaloj të tjerët në kryerjen e veprave penale dhe mjaftueshëm do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer e se do të ngris vetëdijen në respektimin e ligjit për çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

6. Vendimi mbi paraburgimin

Gjykata, duke vepruar në pajtim me nenin 366 par.2 nën par 2.3 të KPRK-së ku përcaktohet se’’: *Trupi gjykues gjithmonë ndërpre në paraburgimin dhe urdhëron lirin e të akuzuarit nëse: është dënuar vetëm me gjobë ose i është shqiptuar vërejtja gjyqësore’*, me aktvendim të veçantë, të pandehurit i ka liruar nga masa e paraburgimit.

7. Vendimi mbi konfiskimin

Gjykata, duke vepruar në pajtim me nenin 269 të KPRK-së ku përcaktohet se: *‘Pas dënimit të të pandehurit për veprë penale, gjykata konfiskon të gjitha pasuritë e specifikuar të përcaktuara në*

aktakuzë ose në njoftim sipas nenit 278 paragrafi 5 të këtij Kodi'', ka konfiskuar sendet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Në bazë të nenit 449 të KPPRK-së, gjykata e ka obliguar të pandehurin që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë paushalle, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

DEPARTAMENTI SPECIAL

PS.nr.33/2023 datë 03.08.2023

Bashkëpunëtori Profesional

Albert Haliti

Kryetari i Trupit Gjykes

Vesel Ismajli

Duke qenë se të gjitha palët e autorizuar pas shpalljes së këtij aktgjykimi kanë hequr dorë nga e drejta për ushtrimin e ankesë kundër tij, aktgjykimi bëhet i formës së prerë menjëherë.